REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit: 01
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 05-2000/2
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages: -02-
Data: / Datum: / Date: 05/05/2020
Prishtinë / a

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
**Ministria e Shëndetësisë**
**Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health**
**Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister**

---

Nr. 272/2/V/2020
Datë.05.05.2020

Në mbështetje të nenit 145, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë për bazë nenin 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, nenin 12 paragrafi 1.11 dhe nenin 89 të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi, nenin 8, paragraf 1.4 dhe Shtojcën 10 paragrafi 1 të Rregullores nr.05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (19.02.2020), duke u bazuar në nenin 3, 4, 41, 44 dhe 47 të Ligjit nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, në zbatim të Vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11 datë 15.03.2020 dhe Nr.01/24 datë 08/04/2020, si dhe në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nr. KO54/20, në zbatim të propozimit të IKSHPK-së, Ministri në detyrë i Ministrisë së Shëndetësisë, nxjerr:

## V E N D I M

**I.** **Lagja** "Dardania" dhe "Apollonia" **në Komunën e Fushë Kosovës,** shpallen vatëra të përhapjes së infeksionit;

**II.** Personat e diagnostifikuar me COVID-19 dhe kontaktet e tyre janë rekomanduar nga IKShPK për vetëizolim. Rekomandohet Policia e Kosovës për mbikqyrje të shtuar të këtyre vendbanimeve;

**III.** Obligohen të gjithë banorët të **respektojnë masat** sipas udhëzimeve të Institutit të Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK);

**IV.** Shfuqizohet Vendimi me nr protokolli 05-2000 i dt.19/04/2020;

**V.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri në një vendim tjetër.

## A r s y e t i m

Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës, si dhe në përputhje të plotë me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. KO54/20 të datës i

publikuar me 6 prill 2020, Ministria e Shëndetësisë bazuar në kompetencat e saja te përcaktuara në Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Arben Vitia**

**Ministër në detyrë i Shëndetësisë**

_______________

*Vendimi i'u dërgohet:*

- *Kryeministrit të Kosovës;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm MSh,*
- *Departamentit Ligjor MSh,*
- *IKSHPK-së;*
- *Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës;*
- *Policisë së Kosovës;*
- *Inspektorati sanitar;*
- *Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike;*
- *Qendrës operative emergjente në MSh;*
- *Arkivit të MSh.*